



PROCESVERBAL VIII/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VIII(tetë) për vitin 2024 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 22.08.2024
Ora : 10:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues

Kryetari i Komunës z.Bali Muharremaj

Të pranishëm tjerë:

z. Urim Suka
znj.Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj.Fidaije Kukaj
z.Dardan Berisha
z.Liridon Fandaj

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhurimin e llaptopave;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - i njofton të pranishmit se ka dhe një pikë shtesë në rend dite nga Drejtoria e Pronës. Ia jep fjalën Drejtorit të Pronës z. Armend Krasniqi.

Armend Krasniqi - është një vendim që është marrë paraprakisht në Asamblenë Komunale. Është formu komisioni për një parcelë në Reshtan, i ka kry të gjitha procedurat komisioni dhe ka konstatu që nuk ka parregullsi dhe e ka sjell në Asamble me qu më tutje.

Kryesuesi - është raport i komisionit. Ka qenë konkurrim i hapur dhe sa po e shoh e paskan bë përzgjedhjen ku përfitues është zgjedh Beqir Krasniqi.

Avni Bytyqi - a ka ofertua si firmë apo si person fizik ?

Armend Krasniqi - ka ofertu si firmë por i autorizuar ka qenë Beqiri.

Avni Bytyqi - nëse ka ofertua si firmë atëherë i jepet firmës.

Kryesuesi - këtu e paska të bërë "Design Lifts" SH.P.K me pronar Beqir Krasniqi.

Urim Suka - unë jam i informuar nga anëtari jonë i komisionit dhe ai më ka sugjeru që gjithçka është në rregull por nuk kam një dokument përpara.

Liridon Fandaj - afati i dhënies në shfrytëzim sa është?

Kryesuesi - është e caktuar me vendim të Asamblesë 99 vite.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Bulëza Kuçi - sa i përket planit të punës ka qenë edhe një raport prej DKA-së në ndërsa nuk ka ardhë këtu si pikë e rendit të ditës. A mund të na jepni sqarime.

Kryesuesi - do të bisedoj me Kryetarin që DKA ta përgatit këtë raport dhe ta sjell seancën e radhës.

E hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-74231;

Kryesuesi - jep sqarime sa i përket shfuqizimit të vendimit.

Urim Suka - pse është dasht me shfuqizu? A s'ka pas mundësi të bëhet plotësim-ndryshim?

Kryesuesi - është procedurë më e lehtë. E hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - gjatë analizës që kam bë si lëndë kuptova që fjala është për objektin në dalje të Suharekës. Aty kam pa që punët kanë fillu që një kohë .A ka pas leje ndërtimore për me vazhdu punën ai atje ku ne s'kemi marrë ende vendim që ajo me u shfrytëzu ? Duke i pa krejt këto më duket që qysh herët është diçka e paramenduar kjo që po ndodh dhe më duket jo e drejtë. Duke pas parasysh të gjitha këto ne nuk mund të japim mbështetje si LDK.

Kryesuesi - ne po diskutojmë për një parcelë të cilën e ceka me numër e cila është në rend dite dhe nuk besoj që është prek mirëpo parcela tjetër mbi të,ne nuk kemi kompetencë dhe është zyra e urbanizmit.

Urim Suka - ndoshta ai e ka lejen dhe nëse e ka lejen është në rregull por nëse procesi nuk ka shku siç duhet,unë nuk po du m'u bë palë. Nëse ju tash ma jepni informatën që leja është në rregull,unë ndoshta e përkrahi edhe vendimin. Për mua është e papranueshme në këtë formë nëse është siç e kam dyshimin.

Kryesuesi - unë pajtohem që ajo pjesë është germu por unë po flas për numër parcelës,pra jasht asaj parcele.

Urim Suka - për atë është me rëndësi me qenë drejtori prezent dhe krejt këto dilema me i sqaru.Dua të lidhem me nenin 4.2 ku shkruan: prona e paluajtshme në fjalë nuk ndërron titullarin juridik,pronar i kësaj mbetet Kuvendi i Suharekës dhe si i tillë ajo nuk mund ti jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit,nuk mund të tjetërsohet,nuk mund të jet objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarë do ngarkese tjetër mbi këtë pronë.A nuk do të paguaj tatim për atë pronë që po e merr në shfrytëzim?

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që ligji për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme i jep kompetencë dhe autoritet kuvendit vetëm për ta dhënë në shfrytëzim pronën publike. Asnjë ligj në Kosovë nuk ekziston për shitjen e pronës publike. Ligji nuk e lejon që pala që e merr në shfrytëzim me ia dhënë palës së tretë në shfrytëzim.

Urim Suka - a paguan tatim ai?

Avni Bytyqi - ky nuk paguan tatim për arsye se komisioni e ka bë me çështje të kompensimit të banesave dhe lokaleve afariste që ndërtohen në atë parcelë.

Urim Suka - këtu po thotë nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore.

Avni Bytyqi - kjo do të thotë nuk ka të drejtë me lënë hipotekë,me lënë një lloj garancioni pronën e komunës Qira ka me pagu, jo tatim. Tatimi paguhet për objekt.

Dardan Berisha - ndoshta do të ishte mirë ne me pas një skicë se për cilën parcelë bëhet fjalë.Pajtohem me kolegun por mendoj që më e rrugës është pyetjet të bëhen në seancën e Asamblesë,me iu drejtu Drejtorit të Urbanizmit se a ka leje të ndërtimit sepse ajo është pjesë shoqërore dhe ne po bisedojmë për një pronë publike të komunës sepse shpesh ne po dalim jasht pikave të rendit të ditës.

Urim Suka - nuk jam kundër por ne jemi betu në kuvend dhe kemi thënë që kemi me qenë të barabartë për të gjithë dhe sipas meje në këtë rast nuk jemi duke i trajtu barabartë.

Liridon Fandaj - Janë tre konkures. Është një dyshim,jo te komisioni por te vet manipulimi i atyre personave. I njejt qe është duke e bë germimin po e përfiton si parcelë. Komisioni duhet me pas një analizë në bazë të vlerësimit dhe këtë analizë ne duhet me pas si dëshmi në bazë të cilave fakte ai komisioni ka vendos që 27% sepse afër saj është 35%.Kudo që bëhet shitblerja ose këmbimi,merret kontrata e fundit për bazë.

Dardan Berisha - nuk jam pjesë e komisionit por varet sa ke dhënë si komunë dhe aq merr.
Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

3 për,3 kundër

Në këtë rast Kryesuesi e përdor votën e dyfishtë dhe voton për

Miratohet pika 3

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për këmbimin e pronës komunale me pronën private;

Kryesuesi - e elaboron pikën dhe hap debatin.

Urim Suka - për mua është shumë e mirë kur e shtron një rrugë dhe shpronësimi kryhet paraprakisht por s'po kuptoj pse drejtorja në fjalë nuk po e sponsorizon komplet këtë problemin që e ka me këtë rrugë dhe me zgjidh me një projekt vendim të përbashkët sepse më duket ka edhe tjera.

Dardan Berisha - puna nuk duhet m'u ndal sepse mundet i treti me t'blloku por s'mund të ndalesh sepse duhet m'u kry procedura.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

5 për,1 apstenim,Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhurimin e laptopave;

Kryesuesi - e laboron pikën dhe hap debatin.

Kryesuesi - edhe mandatin e kaluar ka qenë një vendim i tillë dhe ka kalu.Shpresoj edhe tani të kalojë.E hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.Nuk ka debat,e hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7 shtesë;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën e 7 shtesë.

Unanimisht Miratohet

Takimi përfundoi: **10: 40**

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj